



Prishtinë, 10 prill 2015
Kodi i ZRRE-së: V_726_2015

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.6, nenin 14 paragrafi 2 nënparagrafi 1.7 dhe nenin 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L-185);
- Nenin 4, nenin 5, nenin 6 par. 1, nenin 8, nenin 9, nenin 11 dhe nenin 14 të Rregullës për Skemën Mbështetëse;
- Udhëzimin Administrativ Nr. 01/2013 për caqet e BRE-ve, të nxjerr nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik;
- Vendimin nr. V-673-2014 dt. 23 dhjetor 2014 për përcaktimin e Tarifës nxitëse (Feed in) për prodhimin e energjisë elektrike nga Burimet e Ripërtërithme të Energjisë;
- Vendimin nr. V-653-2014 dt. 03 tetor 2014 për lëshimin e Autorizimit final për shoqërinë "Led Light Tehnology Kosova" SH.P.K., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga panelet solare fotovoltaike, me kapacitet të instaluar prej 102 kW, në Lokacionin Gjurgjevik/Malisheva, ZK Gjurgjevik, komuna e Klinës, dhe
- Aplikacionin/Kërkesën për Pranim në Skemën Mbështetëse për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga panelet solare fotovoltaike, me kapacitet të instaluar prej 102 kW, në Lokacionin Gjurgjevik/Malisheva, ZK Gjurgjevik, komuna e Klinës, të datës 23.02.2015, të shoqërinë "Led Light Tehnology Kosova" SH.P.K., me adresë: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit" rruga Ulpiana C2, Hyrja III, Nr. 6, – 10000, Komuna e Prishtinës, Republika e Kosovës,

në seancën e mbajtur me datë 10 prill 2015 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHET** kërkesa e shoqërisë "Led Light Tehnology Kosova" SH.P.K., dhe **PRANOHET** në Skemën Mbështetëse operatori gjenerues për prodhimin e energjisë elektrike nga panelet solare fotovoltaike, me kapacitet të instaluar prej 102 kW, në Lokacionin Gjurgjevik/Malisheva, ZK Gjurgjevik, komuna e Klinës.
- II. Operatorit gjenerues sipas pikës I. të dispozitivit i garantohet në mënyrë automatike Tarifa Nxitëse për prodhimin e energjisë elektrike nga Burimet e Ripërtërithme të Energjisë.
- III. Operatorit gjenerues sipas pikës I. të dispozitivit i garantohet lidhja e Marrëveshjes për Shitblerje të Energjisë elektrike me Furnizuesit publik në kohëzgjatje 12 vjeçare, e cila do të lidhet së paku (30) ditësh para datës së fillimit të operimit gjenerues.




Arsyetim

- ZRRE me datë 23.02.2015 nga shoqëria “Led Light Tehnology Kosova” SH.P.K., ka pranuar aplikacionin për pranim në skemën mbështetëse për prodhimin e energjisë elektrike nga panejt solare fotovoltaike, me kapacitet të instaluar prej 102 kW, në Lokacionin Gjurgjevik/Malisheva, ZK Gjurgjevik, komuna e Klinës.
 - Bordi i ZRRE-së me datë 03 tetor 2014, shoqërisë “Led Light Tehnology Kosova” SH.P.K., i ka lëshuar Vendimin V-653-2014 mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike.
 - ZRRE, pas vlerësimit të kërkesës/aplikacionit për pranim në skemën mbështetëse dhe analizimit të saj, duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- IV. Ky vendim është pjesë përbërëse e vendimit V-653-2014 dt. 03 tetor 2014 i nxjerr nga Bordi i ZRRE-së, me të cilën i është lëshuar Vendimi mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar, shoqërisë “Led Light Tehnology Kosova” SH.P.K., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga panelet solare fotovoltaike, në pajtim me legjislacionin në fuqi.
- V. Vendim nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- VI. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimin të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE


Enver Halimi, kryesues


Merita Kostari, anëtare


Krenar Bujupi, anëtar